



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-22-98-5-2-1/C520



KONTRAT PUNE

KUSHTET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

TITULLI: Instalimi i ndriqimit te ri dhe riparimi i rrjetit të ndriqimit publik ekzistues në Komunën e Drenasit

Numri identifikues: 611-22-001-521 Datë 06.04.2022

Nr. i arkivit: 400 -14951

NENI 1 PALËT NË MARRËVESHJE

1. KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga GEZIM HAJDINI, Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës")
2. Labinot M. Krasniqi B.I përfaqësuar nga: LABINOT KRASNIQI - Drejtor (me tutje "Kontraktues")

NENI 1: LËNDA

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim:

Instalimi i ndriqimit te ri dhe riparimi i rrjetit të ndriqimit publik ekzistues në Komunën e Drenasit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e puneve qe duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative . Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 07.04.2022 dhe përfundonme 06.04.2025

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë NE KOMUNEN E DRENASIT

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është 320,43 Euro. VLERA E PROJEKTIT ESHTË 90,000 EURO (Nentëdhjetë mije euro)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

NENI 4

RADHITJA E DOKUMENTEVE TE KONTRATËS SIPAS PRIORITETIT

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

NENI 5 KOMUNIKIMET

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

NENI 1 PËRKUFIZIMET

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

NENI 2 GJUHA DHE LIGJI I APLIKUESHËM

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

NENI 3 TRANSFERIMI

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

NENI 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

NENI 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

NENI 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

NENI 7

Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

NENI 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

NENI 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

NENI 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

NENI 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

NENI 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

NENI 14 Paramasa dhe Parallogaria

14.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

NENI 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

NENI 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

NENI 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

NENI 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

NENI 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

NENI 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shumata e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shumata që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shumata proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

NENI 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shumata, e specifikuar në KVK, do të ndalohej nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumata në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shumata totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

NENI 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shumata e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

NENI 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

NENI 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftojë Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryejë të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshojë Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të japë instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vendpunimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

NENI 25 Llogaritja përfundimtare

25.2 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen të paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshojë Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikojë cilëndo pagese finale e cila duhet të paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do të paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

NENI 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

NENI 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

NENI 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

NENI 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

NENI 30
Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktoar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

NENI 31

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

NENI 32

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet Përgjithshme Kontratës	e të	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Të përgjithshmet

Ligji i zbatueshëm dhe gjuha		Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha e përdorur		Gjuha e përdorur do të jetë [gjuha e procedurës - shqipe].
Përgjegjësi dhe Sigurimi i Kontraktuesit		Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve: (sipas ligjeve në fuqi) (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve deri në shumën e kontratës; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën deri në shumën e kontratës; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: sipas ligjeve në fuqi. (ii) të personave të tjerë: sipas ligjeve në fuqi.
Programi	8.1	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Njësia kërkuese dhe komisionin për pranim teknik me një Vendim tjetër. Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë.
Programi i azhurnuar dhe pagesat	8.2	Periodha për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik. Pagesat kryhen ashtu si raporton Organi mbikqyrës, pagesa e fundit kryhet vetëm pasi të ofrohet Garancioni për eliminim e të metave në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës.
Inspektimi dhe testimi	9.1	Inspektimin dhe testimin e materialeve kryen Menaxheri sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testimet e para kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Menaxheri nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Punëkryerësi duhet ta ketë në vendpunishte çdo herë Inxhinierin e prezentuar në dosje të tenderit (NAZIF NAZIFI) inxh. i ELEKTROTEKNIKES). Nëse pas urdhëri prej tre ditëve nuk paraqitet Inxhinieri i OE në vend punishte, Komuna ka të drejtën t'i jap urdhresën e fundit për ndërprerje të kontratës. Poashtu njëjtë vepron edhe kur nuk i angazhon paisjet me të domosdoshme në vendpunishte. Inxhinieri duhet të nënshkruhet çdo herë në situacionet e hartuara nga OE fitues dhe në fletët ditarit të punës. Ndërrimi evnetual i inxhinierit të paraqitur në dosje bëhet vetëm me një arsyetim bindës, me Pëlqin të Menaxherit komunal.
Nënkontraktimi	10.2	OE i lejohe nënkontraktimi deri në 10% të vlerës së kontratës, mbi këtë përqindje dhe deri në 40 % të shumës së kontratës vetëm me aprovimin e Menaxherit dhe Organit mbikqyrës të caktuar nga komuna.
Mbarimi i punimeve	10.3	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Planit dinamik dhe Planit të menaxhimit të kontratës të nënshkruar nga të dy palët.
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuere e defekteve është 2 vite.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas kërkesave dhe paraqitjes së rasteve nga DSHPE.

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjithë Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkallim të ditëve. Nëse ka tejkallim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim për mos futje në penale.
Monitorimi	19.2	Menaxheri i projektit obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Në rast të kërkesës për ndërprerje të punimeve apo kontratës, Menaxheri i Projektit duhet ta njoftoj ZP duke ia bashkangjite të gjitha shkresat, komunikimet, dhe të bindet se janë shterre të gjitha mundësitë konform neneve të kushteve të kontratës. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Parapagimi	20.1	Shuma e parapagimit (avans) : 0
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Siguria e ekzekutimit		Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 30 % e shumës së ofertës, validiteti i sigurimit 06.05.2025
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoriteti Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Mundësisht në mes të dy palëve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [jykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.
Mbikëqyrja	33.1	Menaxher apo Mbikëqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veproj konform Udhëzimit A01, përkatësisht Nenit 61.
Punët shtesë	33.2	Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikëqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	33.3	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumenteve	33.4	Zyrtari ndërlidhës apo Menaxheri para se ta dërgoj dokumentacionin për pagesë në Thesar duhet të binden se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës , aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera të nënshkruara nga inxhinierët, faturat, atestet për materialet e përdorura, shkresat, fletët e ditarit të punës të nënshkruara nga inxhinierët, arsyetimin për tejkallimin e ditëve kalendrike, sigurimet, etj, në të kundërtën e merrë përgjegjësinë.

Arkimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen në ZP.
Hyrja në fuqi	33.5	Kontrata hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve.

Kësaj kontrate i bashkangjitet: Oferta financiare e Tenderuesit (Paramasa dhe parallogaria e çmimeve).

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GEZIM HAJDINI	EMRI:	LABINOT KRASNIQI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	2022	Data:	
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR PROJEKTIN E MIRËMBATJES TË NDRIQIMI PUBLIK, NË KOMUNËN E DRENASIT, PËR VITIN (2022-2023),(2023-2023) dhe (2024-2025) ME SASI INDIKATIVE					Peshimi i pozicioneve	
Përshkrimi		Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Totali me TVSH	%
A						A) 70% e pikëve për vlerësim
1	<p>Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçues LED 80 w, të jenë nga alumini me pesh 4.5 kg, të jenë të rezistueshëm ndaj temperaturave nga -50°C deri +85°C , LED dioda duhet të jetë e mbuluar me PMMA optike që rritë efektin e ndriqimit 95% me mundësi të montimit prej -30 shkallë deri +30 në vertikale</p> <p>Tensioni 110V - 270V AC, 50-60Hz, - Eficiencë 135lm/w,</p> <p>Ngjyra 5500K- 6000 K, Shpërndarjen e dritës asimetrike 1120lm sipas skices ne pershkrim, teknik</p> <p>Jetëgjatësia 100000 orë pune, Forca IK 10 dhe me mbrojtje nga lagështia IP66</p> <p>Trupi ndriqes duhet të ketë sistemin e Dimming-ut 0% - 100%,Trupi ndriçues me të gjitha pajisjet përkatëse duhet të plotësoj këto standarde IEC 62031:2008 .Gjatë punimeve të vendosën masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë nga O E. Në qmim të llogaritet edhe demolimi i trupave të dëmtuar.</p> <p>EN 62031:2008 IEC 62031:2008</p> <p>Garancioni 2 vite, nga dita e pranimit teknik</p>	copë	1	123	€ 123.00	
2	<p>Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçues LED 60 w, të jenë nga alumini me pesh 4.2 kg, të jenë të rezistueshëm ndaj temperaturave nga -50°C deri +85°C , LED dioda duhet të jetë e mbuluar me PMMA optike që rritë efektin e ndriqimit 95% me mundësi të montimit prej -30 shkallë deri +30 në vertikale</p> <p>Tensioni 110V - 270V AC, 50-60Hz, - Eficiencë 135lm/w,</p> <p>Ngjyra 5500K- 6000 K, Shpërndarjen e dritës asimetrike 1120lm sipas skices ne pershkrim, teknik</p> <p>Jetëgjatësia 100000 orë pune, Forca IK 10 dhe me mbrojtje nga lagështia IP66</p> <p>Trupi ndriqes duhet të ketë sistemin e Dimming-ut 0% - 100%,Trupi ndriçues me të gjitha pajisjet përkatëse duhet të plotësoj këto standarde IEC 62031:2008 . Gjatë punimeve të vendosën masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë nga O E. Në qmim të llogaritet edhe demolimi i trupave të dëmtuar</p> <p>EN 62031:2008 IEC 62031:2008</p> <p>Garancioni 2 vite për trupat ndriqes nga dita e pranimit teknik</p>	copë	1	122	€ 122.00	
3	<p>Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçues me Ø250 mm me balon në formë sferike nga materiali i plastikës, ku ka të përfshirë fytyrë për poqen LED E 27, bazën për vendosje në shtyllën metalike dekoruese, dhe poqin LED 40 w.Gjatë punimeve të vendosët masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë nga O E. Grancion 2 Vite për trupat ndriqes.</p>	copë	1	6	€ 6.00	
4	<p>Furnizimi ,transporti dhe punimi i bazamentit të ormanëve MB30 me dimensione 90x 90 x 100cm, ku në qmim të hyj germimi i dheut dhe sasia e betonit dhe punet latuese.</p>	copë	1	0.5	€ 0.50	

5	Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m Ø315 mm në fund të shtyllës dhe Ø190 mm , vendosja e shtyllave të betonit duhet të jenë me standarte të KEDS-it, ku në këtë qmim duhet të llogaritet: a) hapja(germimi i dheut) e gropës me dimensione 0.4*1.5 m b) sasia e betonit për bazament për shtyllat sipas dimensioneve standardeve, c) Sasia e tepert e dheut duhet të transportohet në lokacionin e caktuar nga Menaxheri i projektit. Gjatë punimeve të vendosët masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë nga O.E.	copë	1	1	€	1.00
6	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike të zingtuar 5m me këto karakteristika: <ul style="list-style-type: none"> • Trashësia e mureve të shtyllës 4mm. • Me hot dip galvanizim të nxehtë • Lartësia e shtyllës mbi toke h1= 5 m • Diametri i shtyllës në maje d1= 76 mm • Diametri në fund të shtyllës d2= 191 mm, Vendosja e shtyllave të duhet të jenë me standarte të KEDS-it, ku në këtë qmim duhet të llogaritet: a) hapja(germimi i dheut) e gropës me dimensione 0.4*0.8*0.4 m, b) sasia e betonit për bazament për shtyllat sipas dimensioneve standardeve, c) Pllaka e hekurit së bashku me Bulonat që duhet të vendosen në beton për përforcim të shtyllës, d) Sasia e tepert e dheut që duhet të transportohet në lokacionin e caktuar nga Menaxheri i projektit. Bazamenti për shtyllat e metalike mundë të bëhet edhe me "mbjellje", të shtyllave, ku duhet llogaritur edhe gypi Ø250 mm, me gjatësi prej 1 m), dhe sasia e zhavorit 0.2 mm, dhe betoni për pllakë të betonit 0.5*0.5 m me t=10 cm, dhe punet latuese, kjo pllakë vendosët pas vendosjes së shtyllës	copë	1	0.5	€	0.50
7	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike të zingtuar 9m me këto karakteristika: <ul style="list-style-type: none"> • Trashësia e mureve të shtyllës 4mm. • Me hot dip galvanizim të nxehtë • Lartësia e shtyllës mbi toke h1= 9 m • Diametri i shtyllës në maje d1= 76 mm • Diametri në fund të shtyllës d2= 191 mm, Vendosja e shtyllave të duhet të jenë me standarte të KEDS-it, ku në këtë qmim duhet të llogaritet: a) hapja(germimi i dheut) e gropës me dimensione 0.4*0.8*0.4 m, b) sasia e betonit për bazament për shtyllat sipas dimensioneve standardeve, c) Pllaka e hekurit së bashku me bulonat që duhet të vendosen në beton për përforcim të shtyllës, d) Sasia e tepert e dheut që duhet të transportohet në lokacionin e caktuar nga Menaxheri i projektit. Bazamenti për shtyllat e metalike mundë të bëhet edhe me "mbjellje", të shtyllave, ku duhet llogaritur edhe gypi Ø250 mm, me gjatësi prej 1 m), dhe sasia e zhavorit 0.2 mm, dhe betoni për pllakë të betonit 0.5*0.5 m me t=10 cm, dhe punet latuese, kjo pllakë vendosët pas vendosjes së shtyllës	copë	1	1	€	1.00
8	Furnizimi dhe montimi i shiritit përallajmruës që tregon për vendodhjen e kabllit nëntokësor	m'	1	0.5	€	0.50
9	Furnizimi dhe montimi e gypit të brinjëzuar për vendosje të kabllit nëntokësor me seksion Ø63 mm	m'	1	1	€	1.00
10	Furnizimi ,transporti dhe montimi i klemëve izoluese të përquesit me dim. 70,50,35, 25, dhe 16mm ² (çmimi mesatarë),(2 copa për një shtyllë).	cope	1	1	€	1.00
11	Furnizimi ,transporti dhe montimi i lirave për shtylla të betonit dhe shtyllave metalike, me krah mesatar deri (1.0 - 1.5)m, në qmim të llogariten edhe pjeset që shërbejnë për përforcimin e lirës qoftë në shtyllen e betotit apo dhe metalike	copë	1	9	€	9.00

12	Furnizimi ,transporti dhe montimi i hallkave rrethore për shtylla të betonit,(në diametrim përkatës të shtyllës)	copë	1	1	€	1.00	
13	Furnizimi dhe montimi i pllakave për trupat ndriqes LED prej(40-100)W ,pra pllaka nënkupton pjesën ku janë të vendosur qipat LED, se bashku me paisjet tjera elektronike, si një tërsi.Në qmim të llogaritet edhe demolimi i pllakës së vjetër .	copë	1	5	€	5.00	
14	Furnizimi dhe montimi i trafove për trupat ndriqes LED prej (40-100)W ,në qmim të llogaritet edhe demolimi i trafove të dëmtuara .	copë	1	22	€	22.00	
15	Furnizimi ,transporti dhe montimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjatit shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbratur rezerve të mbrojtur e Dekarpitur me dim (120 x 90 x 30). Ndërprerës - Poç fluroshent 1x18w me bazë 1 copë - Prizë OG 16 A 1 copë - Ndërprerës zgjedhës për kyqje të Ndriçimit I=80A-u-RG10 (me dy pozita 1-0-2)... 1 copë - Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1... copë - 2 dalje ORS - siguresa 6 copë patron 63/A - Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë - Përçues 1x25 mm 2 (m) 15 - Kontaktorë tip CS 160 2 copë Komplet me shtrëngues dhe material tjetër (gypat) si dhe skema njëpolëshe e vendosur brenda dhe numri i ormanit i vendosur jashtë si dhe shenja e rrezikut .Ormani i ndriçimit duhet të ketë 2 dalje për ndriqim dhe një hyrje për furnizim ,qelës trekëndësh si dhe paisjet duhet të vendosen sipas paisjeve të gjendjes ekzistuese të ormanëve të ri.	copë	1	1	€	1.00	
16	Furnizimi dhe montimi i kabllës 4x25mm ² Al, e cila do të shërbëjë për furnizim të ormanve të ndriçimit nga burimi furnizimit,dhe vendoset në shtyllat ekzistuese të betonit dhe shtyllat e reja .	m'	1	2	€	2.00	
17	Furnizimi dhe montimi i kabllës bistek 4x16mm ² Al, e cila do të vendoset në shtyllat ekzistuese të betonit dhe shtyllat e reja që do të vendosen.	m'	1	6.5	€	6.50	
18	Furnizimi dhe montimi i kabllës nëntoksor PPOO-Y - 4x25mm ² Al, e cila do të vendoset në kanal.	m'	1	3	€	3.00	
19	Furnizimi dhe montimi i kabllit NMY-3x(1,5-2.5) mm ² nëpër shtylla të metalit, prej pllakes së Araldinit, deri tek trupi ndriqes.	m'	1	18	€	18.00	
20	Furnizimi , transporti dhe montimi i klemave, papuqeve të Al-Cu për lidhjen kabllës bistek me 4x16mm ² Al . 2 copë për një shtyllë.	copë	1	1	€	1.00	
21	Furnizimi ,transporti dhe montimi (shtrengueseve) për tërheqjen e kabllës bistek për kabëll bistek 4x16mm ² Al . 2 copë për një shtyllë.	copë	1	2	€	2.00	
TOTALI A					€	327.00	

B					B) 30% I pikëve për vlerësim	
22	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës së imët në trashësi 10cm. nën kabell, ndërsa 10 cm mbi kabell. Dim:(0.80x0.40)	m ³	1	1	€	1.00
23	Hapja dhe mbyllja e kanalit me dimensione 0.8x0.4 m, për shtrirje të kablilit nëntokësor, me mekanizem të nevojshem, ku përpjesa e kanalit është 95% me mekanizem dhe 5% me dorë. Në qmim të hyj edhe largimi dhe transporti i dheut të tepert deri në lokacion e caktuar nga menaxheri i kontratës.	m'	1	10	€	10.00
24	Prerja e betonit ose asfaltit, apo hjekja e kubzave në trotuare, parkingje me dim (0.80 x 0.45)m, . Në këtë qmim duhet llogaritur : a)Transportin deri në deponi e matarila të prerë,b) kthimi në gjendje të më parshme (me sasit e betonit , asfaltit apo të kubzave, dhe Furnizimi blerja dhe vendosja e asfaltit ,kubzave, betonit, për sasit të reja)). Llogaria të kryhet për m'	m'	1	5	€	5.00
25	Furnizimi dhe montimi i gypit të brinjëzuar me diameter Ø65 mm, i cili është i pajisur me fije metalike për tërheqje të kablilit , i cili shërben për vendosjen e kablilit nëntokësor, dhe njihert shërben edhe për vendosjen e kablilit të furnizimit në shtylla të betonit, deri tek Ormani Kryesor.	m'	1	1	€	1.00
26	Furnizimi me ngjyrë dhe ngjyrosja e shtyllave të ndriqimit që janë prej materialit të hekurit me ngjyrë metalike (të hirt),ngjyrosja të kryhet me kompresor, mundet edhe me dorë në ato vende ku nuk mund të qaset me paisje.	copë	1	10	€	10.00
27	Furnizimi dhe vendosja e kapakve të përfëruar me bulona adekuat për shtylla të ndriqit publik	copë	1	5	€	5.00
28	Furnizimi dhe vendosja e ndërprerëve të fuqisë të tipit prej (AS-40-160) A, që do të vendosen në ormanet kryesor	copë	1	0.5	€	0.50
29	Furnizimi dhe montimi i releve astrologjike (foto rele) në ormanet kryesor të ndriqimit, në qmim të hyj edhe demolimi i fotoreleve të vjetra aty ku janë të dëmtuara.	copë	1	15	€	15.00
30	Furnizimi dhe montimi i ndërprerëve të tipit RG- 35- me dy pozita (1-0-2)	copë	1	0.5	€	0.50
31	Furnizimi dhe montimi i kontaktorve tip CS (60-160) kw,në ormanet e ndriqimit	copë	1	28	€	28.00
32	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike në bazat e Araldimit, me intenzitet standard në shtyllat e ekzistuese dhe në shtyllat e reja metalike të ndriqimit	copë	1	3	€	3.00
33	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike (nga 16-32)A, në ormanet e ndriqimit	copë	1	3	€	3.00
34	Drejtimi i shtyllave metalike të lakuara(dëmtuara) dhe renovimi i tyre	copë	1	5	€	5.00
35	Demolimi i shtyllave të dëmtuara (drurit, betonit, metalike), dhe bartja deri në lokacionin e caktuar nga menaxheri i kontratës.	copë	1	2	€	2.00
36	Kyqja e tokzimit në shtyllat ekzistues aty ku janë të dëmtuara	copë	1	0.5	€	0.50
37	Furnizimi dhe montimi i shiritit të zingeturar Fe/Zn-35/4 mm	kg	1	1	€	1.00
38	Demolimi Ormanve kryesor të dëmtuar, komplet me paisje(OKSH), ku pasijet e demoluara i dorzohen menaxherit të projektit(nese janë jashtë funksionit), nese janë të pa dëmtuara ato prap mund të vendosen në Ormanin e ri. Në qmim të llogaritet edhe testimi dhe funksionalizimi i plot i sistemit elektrik. Gjatë punimeve të vendosët masat mbrojtje sinjalizuese në rrugë , nga O E.	copë	1	130	€	130.00

39	Furnizimi dhe montimi i kabllit PF 1x 6 mm ² , për tokëzim të kudrove shpërndarës	m'	1	2	€	2.00	
40	Furnizimi dhe montimi i bulonave në kapaket e shtyllave të ndriçimit	copë	1	5	€	5.00	
41	Furnizimi dhe vendosja e bravave për dyer të ormaneve të ndriçimit me qels trekëndesh, ku janë të dëmtuara, në qmim të hyj edhe demolimi i bravës	copë	1	0.1	€	0.10	
42	Furnizimi i shiritit metalik me vrima për përforsim dhe shtangim të kabllit , gypit të brinjëzuar, nëpër shtylla të betonit.	m'	1	0.5	€	0.50	
43	Inqizimi i trasës për gjetjen e defekteve të kabllove nëntokësore të ndriçimit publik, me pasije të veçant (kamion special për gjetjen e defekteve në kabillo nëntokësor), ose me pasije tjera të nevojshme. Në llogari hynë vetëm gjatësia ku bëhet inqizimi i trasës me pasije, dhe vetëm kur nuk mund të gjendet në form vizuale. Gjatë punimeve të vendosën masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë , nga O E.	copë	1	45	€	45.00	
44	Zhvendosja e kabllit të furnizimit Al 4x 16 mm ² , nga një shtyllë e ndriçimit në një shtyll tjetër, ku në qmim të llogariten edhe klemat, lidhëset dhe shtrengueset për kabëll. Gjatë punimeve të vendosën masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë , nga O E.	copë	1	3	€	3.00	
45	Furnizimi dhe montimi i Sheshirave (balonave) të plastikës Ø250 mm, për trupat ndriqes, dhe në qmim hyj edhe demolimi i tyre.	copë	1	12	€	12.00	
46	Zhvendosja e trupit ndriqes, nga një shtyllë e ndriçimit në një shtyllë tjetër, ku në qmim të llogariten edhe klemat, lidhëset dhe shtrengueset për trupin ndriqes. Gjatë punimeve të vendosën masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë , nga O E.	copë	1	15	€	15.00	
47	Furnizimi dhe montimi i lidhëseve për kabell nëntokësor (MUFA), të ndriçimit publikë, per seksione të kabllove (4x25 mm ² , 4x35 mm ² , 4x50 mm ² , 4x70 mm ²), në qmim të llogaritet edhe gërmimi i kanalit dhe kthimi në gjendejn e më parshme.	copë	1	2	€	2.00	
TOTALIB						€ 305.10	

		Çmimi total	Çmimi total i peshuar
Rikapitullim i përgjithshëm			
Totali A prej (1-21) me 70%	€	327.00	€ 228.90
Totali B prej (22-47) me 30%	€	305.10	€ 91.53
Totali (A+B)	€	632.10	€ 320.43
Çmimi i përgjitheshm i peshuar (ofertat do të vlerësohet në bazë të kësaj vlere). Kjo është vlere e cila do të shënohet në formularin e ofertes dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.			€ 320.43

Shënim: Operatori ekonomik ka për obligim që të bëjë sigurimin e punishtës gjat kryerjes se punimeve, me sinjalizim adekuat, dhe merrë përsipër qdo lloj aksidenti të mundshëm gjatë kryerjes se punimeve dhe njëkohësisht merrë përsipër edhe(dëmet dhe riparimet) eventuale që mund të shaktohen në infrastrukturen nëntokësor gjatë hapjes së kanaleve apo gropave për shtylla të ndriçimit publik.

Plani dinamik është gjatë tër vitit kalendarik
Afrim Prokshi



Serial 0700102916598

Për **KOMUNA E DRENASIT**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

Labinot M.Krasniqi BI NNP.TONI

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim te realizimit lidhur me kontratën me titull

Instalimi i ndriqimit te ri dhe riparimi i rrjetit të ndriqimit publik ekzistues në Komunën e Drenasit

të dhënë me numrin e Prokurimt.

611-22-98-5-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

€ 27,000.00

Njezet dhe Shtate mije €

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të githa shumat brenda limiteve të

€ 27,000.00

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen

(shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

06.04.2022

deri më

04.05.2025

Lëshuar në

PRISHTINE

datë

06.04.2022

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit



0009082